



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:122084

Datë: 27.06.2022

Numri i dokumentit: 03174337

C.nr.101/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. F. S. nga Gjilani, Rr. “B. i P.” H-..., K-..., nr..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit me seli në Dragash, të cilën e përfaqëson i autorizuari R. K. nga Dragashi, me bazë juridike pagesën e shperblimeve jubilarë, vlera e kontestit 339,45 €, jashtë seance, me dt. 27.06.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M **NË BAZË TË POHIMIT**

I. APROVOHET si e **BAZUAR** kërkespadija e paditësit A. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit me seli në Dragash, që paditësit t’i paguaj shperblimin jubilar në shumën e përgjithshme prej 339,45 € (treqind e tridhjetë e nëntë euro e katërdhjetë e pesë centi), me kamat ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenimin e përbarimit të dhunshëm.

II. Me shpenzimet procedurale obligohet e paditura, dhe obligohet që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 98 €.

A r s y e t i m

Paditësi A. S., përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi me 03.06.2021, kundër të paditurës Komuna e Dragashit, për pagesën e shperblimeve jubilarë **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë Punëtor Higjienik në Qëndrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash me mbi 10 vite përvojë të punës. Tutje, ka theksuar se duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, konkretisht nënin 17 par. 3, nënpar. 3.1, paditësi verbalisht i është drejtuar të paditurës si punëdhënësi me kërkesë që t’ja paguaj shperblimin jubilar për punën mbi 10 vite, mirëpo e paditura përkundër faktit se e ka pranuar kërkesën verbale të paditësit, përveq premtimeve se këtë pagesë do t’i paguajm pas rishikimit të buxhetit, e njëjta deri më tani asnjëherë nuk i ka paguar. Kërkesa e paditësit është parashtruar konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale nënin 17 par. 3, nënpar. 3.1 për shperblimin jubilar, në vlerë të 1 (një) page mujore të tij, $1 \times 339.45 = 339.45$ Euro, pasi që vlera e një page mujore e paditësit është 339.45 Euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

edhe atë për taksën gjyqësore për padi shumë prej 20.00 Euro dhe 78.00 Euro për perpilimin e padisë.

I autorizuari i të paditurës R. K., me datë 12.05.2022 ka parashtruar përgjigje në padi me shkrim, ku e ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se “Bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë nr. 05-3815 të datës 12.06.2018, përkatësisht në nenin 17 paragrafi 3 me të cilin është percaktuar në mënyrë të specifikuar se punëtorëve shëndetësor me mbi 10 deri 30 vite ju takon shperblimi jubilar, Komuna përkatësisht Drejtoriati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale e pranojmë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi”.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurës, konstatoi se kërkesa e paditësit është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)*” – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se “*Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës*”, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se “*Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre*”.

Meqenëse pala e paditur e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e në kuptim të nenit 148 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 148 p.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos në bazë të nenit 452, 453 dhe nenit 463 të LPK-së si dhe tarifës zyrtare të OAK-ut.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:122084, 27.06.2022**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate. Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.